**KËRKESË**
**Nr. 1671, datë 31.5.2019**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "ELIS LIKA"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **"ELIS LIKA"**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Elvisjon Salku**

**VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT**

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000372-5 Datë *30.4.2019*

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe procesverbalin e inspektimit *nr. ISHMPUT-TR-2019-000372-2*, datë *18.4.2019*, inspektim që është zhvilluar në subjektin "*Elis Lika*", me NIPT *L72105053R*, përfaqësues i autorizuar i subjektit *Elis Lika*, prej datës *18.4.2019, ora 11:00* deri më datën *18.4.2019, ora 15:00*.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë *18.4.2019* dhe e njoftoi në datë *18.4.2019*. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: *Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis", neni 32, pika "1/e"*,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit *nr. 9774, datë 12.7.2007 " Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", nenit/neneve 32, pika "1/e"*, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
*Gjobë 5 000 Lekë*

2. Dënim administrativ plotësues:
*- Pezullim të pjesshëm të aktivitetit të pajisjeve zhurmëprodhuese deri në marrjen e masave për mbrojtjen e zhurmave.*

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eleminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:
Inspektorët Shtetëror të autorizuar:
*Ardit Bubeqi ID: 0301020010*
*Andi Dore ID: 0301020030*

*Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti Elis Lika ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë "Organit Epror", Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*